

VENDIM
Nr. 378, datë 12.6.2024

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “RIVITALIZIMI URBAN I BULEVARDIT MALIQ-DRITHAS”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rivitalizimi urban i bulevardit Maliq-Drithas”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Maliq.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit “truall” dhe “arë”, me një vlerë të përgjithshme prej 133 930 (njëqind e tridhjetë e tre mijë e nëntëqind e tridhjetë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 133 930 (njëqind e tridhjetë e tre mijë e nëntëqind e tridhjetë) lekësh, përballohet nga Bashkia Maliq.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga Bashkia Maliq.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Bashkisë Maliq.

8. Bashkia Maliq kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Maliq.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Korçë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Maliq për pasuritë e shpronësuara, sipas këtij vendimi.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Korçë, pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistrimit të aktit të kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Maliq për pasuritë e shpronësuara, sipas këtij vendimi.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Maliq, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Maliq, Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Korçë dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

LISTA EMËRORE E PRONARËVE, PASURITË E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, TË TË CILËVE PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTTIT PËR SHPRONËSIM PËR INTERES PUBLIK “RIVITALIZIMI URBAN I BULEVARDIT MALIQ–DRITHAS”

Nr .	Të dhënat e pronësisë			Të dhënat kadastrale (sipas kartelës së pasurisë)							Vlerësimet për shpronësim, sipas llojit të pasurisë							Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri	Fshati ose qyteti	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sip. totale (m²)	“Arë” (m²)	“Truall” (m²)	“Arë”			“Truall”			Vlera totale (lekë)	
											Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)		
1	Gafer Albana Anesti Hamide	Seit Seit Seit Seit	Mersinllari Mersinllari Mersinllari Mersinllari	Libonik	2445	14/1	Truall	15		15				15	200	3,000.0	3,000.0	Konfirmuar nga ASHK-ja. Shënim. “Ka lidhje me pasurinë 214/14. Sqarim: Kjo pasuri është kufitare me pasurinë nr. 14/1 dhe nuk preket nga shpronësimi”.
2	Shaban Ylli Naile Zamir Gezim	Qemal	Ali Ali Ali AliAli	Libonik	2445	15/30	Truall	32		32				32	200	6,400.0	6,400.0	Konfirmuar nga ASHK-ja.
3	Andrea Erigena	Belul Astrit	Topa Topa	Libonik	2445	15/19	Truall	15.5		15.5				15.5	200	3,100.0	3,100.0	Konfirmuar nga ASHK-ja. Shënim. “Mbi këtë pasuri ndodhet pjesërisht ndërtesa 15/25-Nd”. Sqarim: Sipas procesverbalit të mbajtur më datë 8.3.2022, nga grupi i punës, Bashkia Maliq, të ngritur me urdhrin nr. 109, datë 7.3.2022, pasuria nr. 15/25-ND, është prishur nuk ekziston, dhe për rrjedhojë nuk është bërë përlogaritja e vlerës së objektit.
4	Caush	Bashkim	Hamzaj	Libonik	2445	15/21	Truall	15		15				15	200	3,000.0	3,000.0	Konfirmuar nga ASHK
5	Vasil	Petro	Talka	Libonik	2445	511/15	Truall	38		38				38	200	7,600.0	7,600.0	Konfirmuar nga ASHK-ja Shënim. “Mbi këtë truall ndodhet ndërtesa me nr. 511/14-Nd”. Sqarim: kjo pasuri nuk preket nga projekti.
6	Shaban Ylli Naile Zamir Gezim	Qemal	Ali Ali Ali Ali Ali	Libonik	2445	511/9	Truall	118		118				118	200	23,600.0	23,600.0	Konfirmuar nga ASHK-ja.
7	Fatmir	Zeni	Agolli	Libonik	2445	31/14	Truall	119		119				119	200	23,800.0	23,800.0	Konfirmuar nga ASHK-ja.
8	Andon Leonora	Nevrus Osman	Demollari Demollari	Libonik	2445	39/41	Arë	39	39		39	170	6630				6,630.0	Konfirmuar nga ASHK-ja.
9	Angjelo	Veis	Demollari	Libonik	2445	39/32	Arë	40.6	40.6		41	170	6970				6,970.0	Konfirmuar nga ASHK-ja.
10	Merko	Mehmet	Merko	Libonik	2445	39/40	Arë	18.7	18.7		19	170	3230				3,230.0	Konfirmuar nga ASHK-ja.

[illegible]